



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

### Angazhimi për Cilësinë

INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin "PËR STATISTIKAT ZYRTARE, Nr.9180, datë 05.02.2004", i ndryshuar, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuara ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice).

INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi ndaj përdoruesit, orientimi ndaj punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.

- **Paanshmëria** - që nënkupton mënyrën objektive dhe të pavarur të prodhimit të statistikave, të lira nga çdo presion politik ose i grupeve të tjera të interesuara, veçanërisht lidhur me përzgjedhjen e teknikave, përkufizimeve dhe metodologjisë më të mirë të përshtatshme për të arritur objektivat e vendosur. Ajo nënkupton disponueshmërinë e statistikave me një vonesë sa më të vogël për të gjithë përdoruesit.
- **Cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore** - INSTAT kujdeset për cilësinë e proceseve dhe produkteve statistikore dhe kështu udhëhiqet nga parimet si: rëndësia, saktësia, koha, përpikëria, e drejta e hyrjes, qartësia, krahasueshmëria dhe koherenca.
- **Orientimi ndaj përdoruesit** - INSTAT përpiqet që të prodhojë statistika sa më afër nevojave të përdoruesve, përpiqet të njohë dhe të përmbush pritshmëritë e tyre dhe

---

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Bul."Zhan D'ark", Nr. 3, Tirana, ALBANIA,

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

[www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al)



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

në këtë mënyrë të sigurojë përmbushjen e plotë të nevojave për të dhëna statistikore zyrtare.

- **Orientimi ndaj punonjësit** - INSTAT kujdeset për kualifikimin dhe trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe kompetencave të tyre, duke ndikuar kështu në rritjen e motivimit dhe kënaqësisë së punonjësve të cilët kontribuojnë efektivisht në proceset e punës.
- **Efektiviteti i proceseve statistikore** - është përdorimi më i mirë i mundshëm i të gjitha burimeve të disponueshme dhe kufizimi i ngarkesës së atyre që përgjigjen. Puna dhe kostoja që kërkon prodhimi i statistikave duhet të jenë në përpjesëtim me rëndësinë e rezultatit të kërkuar.
- **Reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve (response burden)** - INSTAT përpiqet që të dhënat statistikore zyrtare të jenë të kuptueshme për të intervistuarit, në mënyrë të tillë që të reduktojë ngarkesën e raportimit, duke përdorur metoda moderne të mbledhjes së të dhënave si dhe duke përdorur burimet administrative, kur lind nevoja.

DELINA IBRAHIMAJ  
DREJTOR I PËRGJITHSHËM

---

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Bul. "Zhan D'ark", Nr. 3, Tiranë, ALBANIA,

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

[www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al)